



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1866/9 prot.,

Tiranë, më 25.10.2024

VENDIM

Nr. 21, datë 25.10.2024

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1866 prot., datë 08.08.2024, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 24.07.2024, depozituar pranë Autoritetit Publik, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

- *Kopje të raportit të auditimit të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Bankën e Shqipërisë të vitit 2017.*

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 961/1 Prot., datë 29.07.2024, i ka kthyer përgjigje ankueses, duke sqaruar se: “...bazuar në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 27 “Ruajtja e konfidencialitetit dhe e sekretit shtetëror”, raporti i sipërcituar nuk mund t’ju vihet në dispozicion, sepse konsiderohet konfidencial për shkak të informacioneve që përmban, bazuar në nenin 34 në lidhje me nenin 27 të ligjit nr. 154/2014 si dhe nenin 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar”.

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesja i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave, që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së

informacionit, si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga Autoriteti Publik.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr.1866/1 Prot., datë 15.08.2024, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, në vijim, nëpërmjet shkresës me nr. 961/4 Prot., datë 23.08.2024, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1866/2 Prot., datë 23.08.2024, i ka kthyer përgjigje ankueses, duke specifikuar se: “...Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar, në vijim të programit të auditimit nr. 571/1 Prot., datë 29.5.2017 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, auditimin e “Ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” në subjektin Banka e Shqipërisë. Auditimi ka përfshirë periudhën 01.01.2016 – 31.12.2016 dhe ka pasur për objekt vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, zbatimin e buxhetit dhe rregullshmërinë e zhvillimit të ankandëve të bonove të thesarit dhe obligacioneve. Me vendimin e ndërmjetëm nr. 88, datë 28.7.2017 “Mbi auditimin në Bankën e Shqipërisë, me objekt “Për vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, zbatimin e buxhetit, rregullshmërinë e zhvillimit të ankandëve të bonove të thesarit dhe të obligacioneve” për periudhën 01.01.2016-31.12.2016” të Kryetarit të Lartë të Shtetit, është vendosur: “Dokumentacioni përgjatë auditimit, projekt-raporti dhe raporti përfundimtar i auditimit në Bankën e Shqipërisë, me objekt ‘Për vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, zbatimin e buxhetit, rregullshmërinë e zhvillimit të ankandëve të bonove të thesarit dhe të obligacioneve, për periudhën 01.01.2016-31.12.2016, do të trajtohen si ‘konfidencial’. Vendimi është bazuar në nenin 25, gërmat ç dhe k, të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në këto kushte, sikundër disponuar në vendimin e cituar më lart, dokumentacioni i përfutur gjatë këtij auditimi të realizuar në subjektin Banka e Shqipërisë, përfshi dhe projekt-raportin përfundimtar të auditimit, janë klasifikuar si sekrete, të nivelit “konfidencial”, në kuptim të nenit 3/1, germa c, të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar, në fuqi në kohën e marrjes së vendimit të ndërmjetëm. Në këtë vendim nuk është përcaktuar afat për deklasifikimin e dokumentacionit. Niveli i klasifikimit, aktualisht, përputhet me parashikimet e nenit 9, germa c, të ligjit nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Në qëndrimin tonë lidhur me kërkesën e bërë, mbahen parasysh si parashikimet e nenit 6, pika 4, të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” në lidhje me parashikimet e nenit 17, pika 5, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, ashtu edhe parashikimet e neneve 6, pika 2, e 28, pika 1, e ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”.

Neni 6, pika 2, i këtij ligji parashikon: “2. E drejta e njohjes me informacion e klasifikuar kufizohet vetëm tek ata persona që kanë nevojë për njohje dhe përmbushin kriteret e sigurisë”. Neni 28, pika 1: “1. Kanë të drejtë të njihen, të ruajnë, të administrojnë e të transferojnë informacion të klasifikuar vetëm personat, që: sigurojnë të drejtën e njohjes për shkak të detyrës që kryejnë nga titullari i ministrisë/institucionit ose oficeri i sigurimit industrial i kontraktorit; a) janë të brifuar më parë për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësive individuale për shkeljet e sigurisë; dhe b) janë të pajisur me CSP, me përjashtim të rasteve për njohjen me informacionin e klasifikuar në nivelin “I kufizuar”. Sa më lart, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për detyrë të ruajë konfidencialitetin e të dhënave dhe dokumentacionit të krijuar gjatë auditimit të kryer në subjektin Banka e Shqipërisë në zbatim të vendimmarrjes së kohës lidhur me këtë dokumentacion, dispozitat ligjore të sipërpërmendura si dhe të parashikimeve të nenit 34 në lidhje me nenin 27 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesja ka vijuar me ankimin e regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1866/3 Prot., datë 09.09.2024, duke kërkuar urdhërimin e dhënies së dokumentacionit nga Autoriteti Publik sipas kërkesës për informacion, me pretendimin se: “...siç shprehet në përgjigjen e dërguar Kontrolli i Lartë i Shtetit vendimi është i klasifikuar “konfidencial”. Ligji nuk përmban në asnjë rast thonjëza për klasifikimin konfidencial, ose është i klasifikuar si i tillë ose nuk është klasifikuar i tillë. Gjithashtu, Kontrolli i Lartë i Shtetit shprehet se vendimi bazohet në nenin 25, gërma ç dhe k të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, por nëse lexon këtë nen sipas pikave të cituara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, konstatohet se asnjëra prej tyre nuk i jep të drejtë Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të klasifikojë dokumente. Konkretisht ligji thotë se “Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është përgjegjës dhe vendos për: ç) marrjen e vendimeve për raportet e auditimit, për masat administrative dhe civile, që u rekomandohen subjekteve pas përfundimit të auditimit; k) për çështje të tjera të specifikuara me ligj. Në ligj nuk specifikohet në asnjë rast se është në kompetencën e Kryetarit të Shtetit të klasifikojë dokumentacion, por ndalon publikimin e tyre nëse ato janë klasifikuar të tilla nga një institucion që e ka këtë tagër. Lidhur me argumentimet që jepen mbështetur në ligjin nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dëshiroj të argumentoj se nuk jemi përpara rastit të aplikimit të këtij ligji, pasi nuk kemi të bëjmë me informacion të klasifikuar, por për rezultat auditimi mbështetur në pasqyrat financiare publike të Bankës së Shqipërisë dhe pagesa të kryera për mallra dhe shërbime të punës së përditshme të këtij institucioni që në asnjë rast nuk lidhen me “sekretin shtetëror”. Ka një deklaratë në Komisionin Parlament të Ekonomisë të ish-Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili ka thënë se informacioni sekret i është refuzuar t’i jepet grupit të auditimit nga ana e Bankës së Shqipërisë pasi nuk kanë qenë të pajisur me certifikatë sigurie, ç’ka forcon faktin që raporti i auditimit nuk përmbush asnjë bazë për t’u klasifikuar konfidencial. Klasifikimi konfidencial jashtë kompetencave ligjore nga ish-Kryetari, nuk do të thotë që institucioni të vijojë paligjshmërinë. Madje si shembull analog mund të konsiderohet rasti i klasifikimit konfidencial i auditimit të Inceneratorit të Tiranës, u rishikua më pas nga ish – Kryetari i KLSH dhe u publikua. Nëse marrim një rast të supozuar se grupi i auditimit ka ndeshur informacion konfidencial, jo çdo fjalë e raportit është konfidenciale dhe asnjë gjetje apo pikë e këtij

raporti nuk është vënë në dispozicion të kërkuarit, në kundërshtim me urdhrin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale të datës 15.08.2024.”

Në këto kushte, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, me Urdhrin nr. 156, datë 30.09.2024, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik duke filluar nga data 08.10.2024.

Pranë Autoritetit Publik u depozitua, urdhri i inspektimit administrativ, i cili u protokollua me nr. 1180 prot., datë 02.10.2024.

Gjatë inspektimit, grupi i inspektimit kontaktoi me koordinatoren për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, e cila, sqaroi se: *“Kërkesa për informacion e znj. është administruar në KLSH në datën 25.07.2024 me nr. Prot. 961 dhe ka marrë përgjigjen e hartuar nga ana ime dhe e konfirmuar nga drejtori juridik, brenda afatit ligjor. Pas përgjigjes së KLSH, kërkuari ka bërë ankesë pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit të cilit i është kthyer përgjigje me nr. prot. 961/1 nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit duke vënë në dijeni dhe kërkuarin. Gjithashtu, bëj me dije se përgjigja drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit është kthyer në datën 23.08.2024 nga Drejtori i Departamentit Juridik, Bledar Mustafaraj.*

Për sa më sipër, grupi i inspektimit kërkoi të kontaktojë me z. Bledar Mustafaraj, me detyrë drejtor i Drejtorisë Juridike pranë Autoritetit Publik, i cili nga deklarimi i koordinatores dhe dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, rezultoi se ka trajtuar kërkesën për informacion.

Grupi i inspektimit kontaktoi me z. Bledar Mustafaraj, i cili sqaroi se: *“Më është kaluar për trajtim shkresa nr. 1866/1 prot., datë 15.8.2024 e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, pasi në ato data, koordinatori, ishte me leje vjetore. Kam shqyrtuar praktikën e kërkesës së bërë si dhe kam kërkuar dosjen e auditimit të subjektit Banka e Shqipërisë, në zyrën e arkivës së KLSH. Nga dosja është vënë re se në të gjendej një vendim i ndërmjetëm i marrë nga titullari i institucionit, me të cilin të gjithë aktet e kësaj dosjeje auditimi nga momenti i marrjes së vendimit, janë klasifikuar si “konfidenciale”. Vendimi ka pasur referencat përkatëse ligjore. Mbi bazën e këtyre të dhënave, është përpiluar shkresa nr. 961/4 Prot., datë 23.08.2024 drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit, bërë për dijeni kërkuarës. Arsyet janë parashtruar në këtë shkresë.”*

Në vijim, Autoritetit Publik i'u kërkuar që anëtari i grupit të inspektimit, i pajisur me Certifikatën e sigurimit të personelit (CSP), të këqyri dokumentacionin e kërkuar, objekt i urdhrin të inspektimit, në përputhje kjo me kriteret e parashikuara në pikën 1 të nenit 28 të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Gjithashtu, u kërkuar që të vendoset në dispozicion të grupit të inspektimit, urdhri i miratimit të listës së informacioneve të klasifikuara “Sekret Shtetëror” në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga këqyrja e dokumenteve të mësipërme, rezultoi se nuk ndodhemi përpara procedurës së klasifikimit në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për

informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar, në fuqi në atë kohë, por, dokumentacioni është klasifikuar si “konfidencial”, në zbatim të Vendim (i ndërmjetëm), nr. 88, datë 28.07.2017, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Mbi auditimin në Bankën e Shqipërisë, me objekt “Për vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, zbatimin e buxhetit, rregullshmërinë e zhvillimit të ankandëve të bonove të thesarit dhe të obligacioneve, për periudhën 01.01.2016 – 31.12.2016”.

Lidhur me urdhërin e miratimit të listës së informacioneve të klasifikuara “Sekret Shtetëror” në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Mustafaraj sqaroi se për periudhën në fjalë, viti 2017, nga kërkimet në arkivën e institucionit nuk u gjet një urdhër i brendshëm.

Në përfundim të inspektimit u lexua procesverbali nga të pranishmit dhe pasi u gjet i shkruar drejtë, u nënshkrua rregullisht nga të dyja palët.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: “... Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 1866/7 prot., datë 11.10.2024, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seanca u zhvillua me prezencën e ankueses dhe në mungesë të Autoritetit Publik, i cili me e-mail-in datë 17.10.2024 njoftoi mospjesëmarrjen.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesën e saj. Ndërkohë, Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës me nr. 1180/3 prot., datë 16.10.2024, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1866/8 prot., datë 16.10.2024, depozitoi pranë Komisionerit pretendimet e nëpunësit që ka trajtuar kërkesë/ankesën objekt shqyrtimi, duke rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur gjatë inspektimit.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, qëndrimin të mbajtur nga nëpunësi i Autoritetit Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, argumentet e parashtruara për ankesën objekt shqyrtimi, nuk janë në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: “Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”. Në kuptim të këtij parashikimi, Kontrolli i Lartë i Shtetit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Komisioneri konstaton se, nëpunësi i Autoritetit Publik, ka bërë një interpretim të gabuar të Vendimit (të ndërmjetëm), nr. 88, datë 28.07.2017, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili, si bazë ligjore të tij ka shkronjat “ç” dhe “k” të nenit 25 të ligjit nr. 154/2014

“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Ndërkohë, ky nëpunës, e ka konsideruar dokumentacionin e kërkuar të klasifikuar si sekret, të nivelit “konfidencial”, në kuptim të nenit 3/1, germa c, të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar, legjislacion ky në fuqi në kohën e marrjes së vendimit të ndërmjetëm.

Ndër të tjera, ky nëpunës ka deklaruar se: *“...me kërkesën e bërë, mbahen parasysh si parashikimet e nenit 6, pika 4, të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” në lidhje me parashikimet e nenit 17, pika 5, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, ashtu edhe parashikimet e neneve 6, pika 2, e 28, pika 1, e ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”.*

Neni 17, pika 5 parashikon se: *“E drejta e informimit nuk kufizohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin, sipas “ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Autoriteti publik njofton menjëherë kërkuar për fillimin e procedurës për rishikimin e klasifikimit, sipas ligjit, dhe vendos shtyrjen e afatit për dhënien e informacionit brenda 30 ditëve pune. Në çdo rast, vendimi për trajtimin ose jo të kërkesës për informim merret dhe arsyetohet në bazë të kriterëve të këtij neni.”.*

Ndryshe nga sa u deklarua, gjatë shqyrtimit administrativ, nuk u provua në asnjë moment se është respektuar procedura e parashikuar në dispozitën e mësipërme.

Për më tepër, për sa i përket bazës ligjore të referuar si shkak për kufizimin e informacionit, konkretisht Vendimi (i ndërmjetëm), nr. 88, datë 28.07.2017, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 25 Përgjegjësitë, ku parashikohet se: *Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është përgjegjës dhe vendos për: ç) marrjen e vendimeve për raportet e auditimit, për masat administrative dhe civile, që u rekomandohen subjekteve pas përfundimit të auditimit; ... k) për çështje të tjera të specifikuar me ligj, Komisioneri vlerëson se këto parashikime nuk mund të legjitimojnë titullarin e Autoritetit Publik që të klasifikojë një dokumentacion si “konfidencial”, pasi, kjo procedurë rregullohet nga legjislacioni i posaçëm për informacionin e klasifikuar.*

Garantimi i të drejtës për informim të dokumenteve publike, është sanksionuar nga neni 23 i Kushtetutës, ligji nr. 45/2022, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për aksesin në dokumente zyrtare’”, ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, i ndryshuar si dhe ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet qartazi rendi i akteve normative të cilat duhet të zbatohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si më poshtë:

- 1- *Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:*

- a) Kushtetuta;
 - b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
 - c) ligjet;
 - ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.
- 2- Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.
- 3- Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.

Për sa më sipër, përsa kohë procedura e klasifikimit nuk është kryer në përputhje me parashikimet e ligjit për informacionin e klasifikuar, por bazohet vetëm në vendimin e ndërmjetëm nr. 88 të Kryetarit të Autoriteti Publik, i cili nuk rezultoi të kishte tagra për kufizimin e informacionit publik, trajtimi i praktikës duhet të ishte bërë në zbatim të nenit 17 të LDI, pasi është kjo dispozita që parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Në këto kushte, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur në kundërshtim me LDI dhe legjislacionin e posaçëm për informacionin e klasifikuar.

Në çdo rast, duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me politikat monetare, zbatimin e buxhetit si dhe zhvillimin e ankandeve të bonove të thesarit dhe obligacioneve të shtetit Shqiptar, interesi publik për të aksesuar informacion/dokumentacion, në këtë rast është i drejtpërdrejtë dhe i lartë.

Për sa më sipër parashtruar, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2 të nenit 2, të LDI sipas të cilës: *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Në këto kushte, Autoriteti Publik duhet ta vendosi atë në dispozicion të kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar, sipas të cilës: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Pas shqyrtimit në tërësi të provave, sa i përket përgjegjësisë për refuzimin e dhënies së informacionit, nga verifikimi i dokumentacionit administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, deklaramentit gjatë inspektimit të kryer dhe parashtrimeve të depozituara nga Autoriteti Publik, Komisioneri konstaton se, z. Bledar Mustafaraj, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, ka refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në kundërshtim me LDI dhe legjislacionin e posaçëm për informacionin e klasifikuar.

Z. Mustafaraj, gjatë inspektimit, i`u komunikua se kërkesa është trajtuar brenda afatit të përcaktuar në LDI, duke refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar me argumentin si më sipër trajtuar. Lidhur me këtë konstatim nga ana e nëpunësit nuk u paraqit asnjë pretendim, vërtetuar kjo nga procesverbali i mbajtur pranë Autoritetit

Publik, në të cilin citohet se: “...Përfaqësuesit e Autoritetit Publik parashtruan se janë dakord me inspektimin e kryer dhe të gjitha referencat e përmendura më sipër. Procesverballi pasi u lexua nga të pranishmit dhe pasi u gjet i shkruar drejtë, nënshkruhet rregullisht”.

Gjithashtu, me shkresën nr. 1866/7 prot., datë 11.10.2024, Komisioneri, në zbatim të nenit 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 24 të LDI, ftoi në seancë dëgjimore nëpunësin që ka trajtuar ankesën objekt shqyrtimi i cili nuk u paraqit, por depozitoi prapësimet nëpërmjet shkresës nr. 1180/3 prot., datë 16.10.2024, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1866/8 prot., datë 16.10.2024.

Në këto kushte, bazuar në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 18 të LDI, *refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë.*

Bazuar në pikën 4 të nenit 19, të LDI, *çdo person përgjegjës, i cili me veprimet dhe mosveprimet e tij shkel dispozitat e këtij ligji, ka përgjegjësi administrative për kundërvajtjet administrative të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 2, të nenit 18 të këtij ligji.*

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Gjithashtu, ankuesja është gazetareske, e cila synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen “*Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë*”, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias, ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “*mbikëqyrësit shoqërorë*”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 4 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014

“Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së znj. _____, nr. 1866 prot., datë 08.08.2024, ndaj Autoritetit Publik, Kontrolli i Lartë i Shtetit, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 24.07.2024, konkretisht: “Kopje të raportit të auditimit të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Bankën e Shqipërisë të vitit 2017”, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6, të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, brenda datës 01.11.2024.
3. Dënimin e z. Bledar Mustafaraj, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë Juridike, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoha ekzekutohet nga Drejtoria e Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit në përputhje me nenin 23 të ligjit të sipërcituar.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1 dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
6. Ky vendim u shpall sot në datë 25.10.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi